



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të nenit 50, pika 3 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në kuadër të anëtarësisë në Observatorin Europian Audiovizual, kërkon të rekrutojë 1 (një) ekspert të jashtëm të kualifikuar në fushën e Filmit dhe Kinematografisë.

TERMAT E REFERENCËS

Qëllimi

Mbledhja e të dhënave për industrinë e filmit dhe prodhimeve audiovizuale në Shqipëri si dhe shkalla e respektimit të së drejtës së autorit në filmat shqiptar, në kuadër të raportimeve pranë Observatorit Evropian Audiovizual.

Detyrat

Eksperti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

1. Përgatitja e materialeve për raportimet periodike të AMA-s pranë Observatorit Europian Audiovizual, lidhur me çështjet e filmave dhe prodhimeve audiovizuale;
2. Mbajtja e komunikimeve dhe përgatitja e kërkesave për informacion drejtuar strukturave publike të brendshme (Qendra Kombëtare Kinematografike, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit,) për çështje të filmave dhe të prodhimeve audiovizuale;
3. Informimin mbi aspekte të së drejtës së autorit në filmat shqiptarë dhe shkallën e respektimit të saj.

Periudha e zbatimit të detyrave

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët.
Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm

1. Të zotërojë diplomën në degën Regji/Regji filmi dhe televizioni dhe/ose të ngjashme;
2. Të ketë eksperiencë pune, bashkëpunime me organizata që veprojnë në fushën e kinematografisë, televizione, evente kombëtare kulturore, etj.;
3. Të ketë punë të ngjashme;
4. Të jetë shtetas/e shqiptar.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

1. Diplomë në degën Regji/Regji filmi dhe televizioni dhe/ose të ngjashme;
2. Dokumentacion që vërteton punë të ngjashme në organizata, televizione, evente kombëtare kulturore, etj.
3. Jetëshkrimi;
4. Kopje ID/Pasaportë;

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

- a. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, e të përvojës të lidhura me fushën,
- b. Dokumentacionin që vërteton arsimin dhe eksperiencat e mëparshme në punë.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e ekspertizës së tyre;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë në realizimin e detyrave.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Kandidatet duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar (original ose kopje e njehësuar me origjinalin) brenda afatit pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të Autoritetit të Mediave Audiovizive

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, nr.15, 1010, Tiranë

APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 12.07.2020

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 02.07.2020